



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT BUXHETOR

**U D H Ë Z I M**

**Nr. 8 Datë 07/03/2014**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN DHE ZBATIMIN E LIMITEVE TË ANGAZHIMIT, PËR VITIN 2014**

Në përputhje me Nenin 24 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Pikën 2 dhe 3 të VKM nr.110 datë 27.02.2014 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017”, Ministri i Financave:

**U D H Ë Z O N:**

1. **Limiti angazhimi**, në kuptim të këtij udhëzimi, do të konsiderohet përpjesa e diferencës ndërmjet tavanit të shpenzimeve buxhetore dhe kontratave të lidhura të çdo ministrie linje/institucioni qendror, pra përpjesa e fondit të lirë i cili mund të jetë subjekt i kontraktimeve të reja.
2. Kontrolli mbi respektimin e limitit të angazhimit bëhet nga degët e thesarit dhe monitorohet nga Njësia e Posaçme e Administrimit dhe Monitorimit të Detyrimeve të Prapambetura (NJPAMDP), në Ministrinë e Financave.
3. Limiti i angazhimit është vjetor dhe tre-vjeçar. Limiti vjetor i angazhimit përcaktohet dhe kontrollohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), mbështetur në ligjin vjetor të buxhetit. Limiti tre-vjeçar i angazhimit përcaktohet duke u mbështetur në tavanet tre-vjeçare të miratuara me VKM, si pjesë e procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).
4. Bazuar në procedurat e parashikuara për përgatitjen e kërkesave buxhetore në Udhëzimin nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës **brenda datës 17 Mars 2014**, duhet të bëjnë ndarjen e tavanëve të tyre buxhetore të PBA 2015-2017, sipas programeve/njësive të qeverisjes qendrore.
5. Bazuar në procedurat e parashikuara në pikat 22 deri 33 të Udhëzimit Plotësues nr.3 datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, **brenda datës 21 Mars 2014**, do të depozitojnë në hard-copy dhe elektronikisht (me e-mail) në degën respektive të Thesarit tavanin e shpenzimeve, kontratat e lidhura për vitet 2015, 2016, 2017 si edhe, limitet e angazhimeve të tyre tre-vjeçare për periudhën 2015-2017.
6. Limitet e angazhimeve për periudhën 2015-2017, do të përcaktohen si mëposhtë:
  - i) **30 përqind** të fondit të mbetur, pas zbritjes nga tavanin e zërit “shpenzime të tjera korente”, i kontratave ekzistuese të lidhura në këtë zë; si edhe
  - ii) **50 përqind** të fondit të mbetur pas zbritjes nga tavanin e zërit “shpenzime kapitale të brendshme”, i kontratave ekzistuese të lidhura në këtë zë.
7. Pas kësaj, çdo urdhër prokurimi për kontratat shumë-vjeçare, përpara përcjelljes tek Agjencia e Prokurimit Publik (APP), do të **siglohet nga degët e thesarit** pas kontrollit me niveli e limitit të angazhimit, pra nëse ai lejon mbulimin me fonde të një kontrate të tillë.

8. Degët e thesarit sigurohen që vlera e kontratave të lidhura, e ndarë/e raportuar nga njësia e qeverisjes qendrore për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, të jetë e barabartë me gjendjen e kontratave të lidhura (stokut të kontratave) në **1 Janar 2014**, te regjistruara ne SIFQ.
9. Të gjitha degët e thesarit, **brenda datës 31 Mars 2014**, paraqesin për dijeni pranë NJPAMDP në Ministrinë e Financave, në hard-copy dhe elektronikisht me e-mail, informacionin përmbledhës lidhur me limitet e angazhimeve dhe kontratat e lidhura, ne nivel program përçdo ministri linje/institucion qendror.
10. Regjistrimi dhe raportimi **sipas Pikave 5) dhe 9)** mësipër, do të bëhet mbi bazë të një **database**-i të veçantë në format Excel, i cili paraqitet përkatësisht në **Shtojcat A** të këtij Udhëzimi.
11. Të gjitha degët e thesarit, **brenda datës 10 të çdo muaji** pasardhës, paraqesin në hard-copy dhe elektronikisht me e-mail pranë NJPAMDP informacionin mbi kontratat e reja të lidhura gjatë muajit paraardhës, sipas **Shtojcës A** të këtij Udhëzimi. Kjo njësi raporton lidhur me informacionin e marrë, tek Nëpunesi i Parë Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave).
12. Ky udhëzim i shtrin efektet e tij **deri në datën 31 Dhjetor 2014**. Pra, deri në momentin e funksionimit të plotë të sistemit të përcaktimit dhe kontrollit të tavaneve dhe kontratave shumë-vjeçare, brenda kuadrit të SIFQ.
13. NJPAMDP në Ministrinë e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore, vë në dispozicion përçdo njësi të qeverisjes qendrore adresën email: [adajko@minfin.gov.al](mailto:adajko@minfin.gov.al) dhe [vrusi@minfin.gov.al](mailto:vrusi@minfin.gov.al).

**MINISTËR I FINANCAVE**

---

**SHKËLQIM CANI**